

RENDI I DITËS

**Shorti “Për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 94 me objekt,
“Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 745,
dt.4.09.2023”, subjekti ankues Partia Demokratike (Sali Berisha)”**

PJESËMARRJA :

- **KAS** **Z. E. Lako, z. E. Çefa, z. I. Rusmali**
- **Stafi** **KQZ:** **Z. Y. Merkaj, z. M. Bardhi**

Z. Y. Merkaj: Sot në datën 6.09.2023, ora 11:00 hidhet shorti për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 94, të paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datën 5.09.2023, ora 19:15. Procedura për caktimin e relatorit është përcaktuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në një të një prej tyre është shënuar kërkesa ankimore nr. 94. Katër shiritat e tjerë janë të bardhë e pa shënime. Të pestë shiritat futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë transparente. Anëtarët e KAS-it janë të pranishëm, por kanë dhënë autorizimin për të tërhequr goglat në emër dhe për llogari të tyre. Një përfaqësues i KQZ-së do të tërheqë goglat në emër dhe për llogari të anëtarëve të KAS-it, duke filluar nga rendi alfabetik rritës. Fillojmë me emrin e parë zotin Elvin Lako, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe në fund zoti Ledio Braho.

Pesë goglat janë në një enë transparente. Pasi përzjehen nga përfaqësuesja e KQZ-së, tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Elvin Lako: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Elvis Çefa: – Kërkesa ankimore nr. 94.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.09.2023*

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Ilirjan Rusmali: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Koli Bele: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Ledio Braho: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit, relator i kërkesës ankimore nr. 94 është zoti
Elvis Çefa. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

6.09.2023
Ora 11:09

RENDI I DITËS


"Për rishqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023 të depozituar nga
partia politike "Partia Demokratike e Shqipërisë".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. E. Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali,
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj, z. M. Bardhi.
- **Parti Politike:** PD (z. I. Sefa)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Lako: Mirëdita të gjithëve. Çelim seancën e sotme për rishqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr. 93 të depozituar në datën 20.08.2023, nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë. Kjo seancë çelet në vijim të vendimit të Kolegjit Zgjedhor nr. 34, datë 1.09.2023, me anë të të cilit është vendosur pranimi i padisë. Shfuqizimi i vendimit nr.179, dt.22.08.2022 i Komisionit Të Ankimimeve dhe Sanksioneve "Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 93, dt. 20.08.2023, depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë". Me këtë vendim është detyruar Komisioni i Ankimimeve dhe sanksioneve për të marrë një vendim përfundimtar në lidhje me këtë kërkesë ankimore. Sipas shortit të hedhur relator i kësaj çështjeje jam zgjedhur unë, Elvin Lako. Para se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes bëjmë verifikimin e palëve pjesëmarrëse Për palën ankuese ju lutem?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Indrit Sefa, përfaqësues i përhershëm i Partisë Demokratike në KQZ.


Z. E. Lako: Për palën tjetër Partia e Lirisë është zoti Kaziaj të cilit i është bërë njoftimi dhe nuk ka ardhur. Në këto kushte do të vazhdojmë. Ka ndonjë kërkesë për palë të interesuar? Nuk ka në sekretari. Mirë për palët, për përfaqësuesin e Partisë Demokratike ka ndonjë kërkesë paraprake në lidhje me shqyrtimin e kësaj çështjeje në themel për konflikt interesi, apo ndonjë diçka tjetër?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo nuk kemi.

Z. E. Lako: Nuk ka! Në këto kushte vijojmë me shqyrtimin në themel të çështjes. I lutem zotit Sekretar i Përgjithshëm dy fjalë në lidhje me themelin, me pretendimin e palës ankuese.

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 722, ka caktuar paritë politike të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e KZAZ nr.11, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetarin e Bashkisë Kukës, që do të zhvillohen në datën 24 shtator 2023”. Kundër këtij vendimi, pra duke mos qenë dakord me këtë vendim të KSHZ, Partia Demokratike duke pretenduar se është partia e parë opozitare, ka bërë ankim në KAS. KAS-i me vendimin nr. 179, dt. 22.08.2023 ka vendosur mospranimin e kërkesës ankimore pasi mungon interesi i ligjshëm. Duke mos qenë dakord as me vendimin e KAS-it, Partia Demokratike ka ankimuar me anë të kërkesë-padisë në Kolegjin Zgjedhor duke pretenduar se vendimi i KAS-it është i paligjshëm. Kolegji Zgjedhor vlerëson se KAS-i ka vendosur se nuk ka interes të ligjshëm për të ankimuar vendimin e Komisionerit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Shtetëror të Zgjedhjeve. Kolegji Zgjedhor ka vlerësuar se ankuesi në procedurë administrative ka arritur të provojë ekzistencën e shkaqeve ligjore, për ekzistencën e interesit të ligjshëm kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për këto arsye ka vlerësuar se vendimi objekt gjykimi përbën vendim të shqyrtimit në themel dhe nuk është vendim paraprak siç ka vendosur KAS-i. Në këto kushte ka prishur vendimin e KAS-it dhe e ka kthyer për rigjykim, duke detyruar KAS-in të shqyrtojë çështjen në themel, faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Merkaj! Unë e relatova shkurtimisht se çfarë vendosi kolegji dhe pse jemi mbledhur dhe pse po e shqyrtojmë në themel. Po flisja tani për themelin e çështjes, apo nuk keni në këtë fazë diçka për të shtuar. Dakord! Pala ankuese, shkurtimisht në lidhje me pretendimet tuaja, sepse ju i keni bërë me shkrim, në rast se keni diçka të re?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po kemi diçka të re që lidhet me gabimin që në fillim, se kjo problematikë fillon që në regjistrimin e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, që është totalisht në kundërshtim me dispozitat e ligjit. Në marrëveshje ligji detyron që të përcaktohen në listën shumëmemërore, përkatësia e partisë politike të kandidatit. Për një marrëveshje dhe një hile të palës kërkuese dhe me miratimin e Komisionerit, me gjithë ankimin e Partisë Demokratike, përsëri KAS-i mbajti standardin që nuk legjitimohemi për subjektin tjetër zgjedhor, megjithëse ishim në garë. Nuk legjitimohemi të kërkojmë përmbushjen e detyrimit ligjor të subjektit zgjedhor, se kështu është standardi i vendosur dhe nuk kemi çfarë ti bëjmë kësaj. Edhe Kolegji Zgjedhor mbajti këtë standard, të themi të drejtën, nuk është vetëm faji juaj. U regjistrua një koalicion partish në shkelje të ligjit. Më saktësisht neni 67, pika 4, ku përcaktohet fare qartë se si bëhet regjistrimi i subjekteve zgjedhore. Sot jemi përpara

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 6.09.2023

faktit të kryer. Komisioneri si asnjëherë më parë, nxjerr një vendim për shpërndarjen e fondeve, ku thotë subjekti “Bashkë Fitojmë”, ka marrë 18.6 % të votave të vlefshme. Kaq vlera për votë dhe kaq lekë, për subjektin “Bashkë Fitojmë”. Tani, po ta marrim nga dispozitat e Kodit Civil. Çfarë është një koalicion partish. Është një shoqëri e thjeshtë! Është një shoqëri, ku dy subjekte për një qëllim të caktuar, për të bërë një punë të caktuar bashkohen për një afat të caktuar, si një shoqëri e thjeshtë. Çfarë thotë dispozita e Kodit Civil, thotë: duhet të përcaktohet përqindja. Ndaj dhe legjislatori te neni 67 thotë: kujt i përkasin kandidatët. Duhet të përcaktohet qartësisht se kujt i përkasin kandidatët. Kjo shoqëri e thjeshtë e ka mbaruar tani më qëllimin e saj të ekzistencës, është shkrire, nuk kemi më një subjekt. Nuk është më subjekt. Kush e përfaqëson këtë subjekt sot, subjektin “Bashkë Fitojmë”? Është ngritur vetëm për zgjedhjet lokale të 14 majit. E ka mbaruar qëllimin e tij, nuk ekziston më. Është një subjekt që nuk ka më asnjë efekt. Nuk mund të paraqesë më asnjë efekt ligjor. Kush e përfaqëson këtë subjekt? Kemi parë pastaj që ka dalë dhe Komisioneri ka bërë interpretim duke thënë se “partia kryesore, drejtuese e koalicionit, merr të gjitha përgjegjësitë dhe të drejtat”. Po! Por gjatë kohës që është subjekt zgjedhor! Sot nuk është më subjekt zgjedhor dhe ligji thotë “parti politike”. Pse i jemi referuar nenit 88? I jemi referuar nenit 88 posaçërisht, sepse është e vetmja dispozitë e cila mund të merret për analogji. Nuk ka një dispozitë tjetër Kodi Zgjedhor për të marrë për analogji mënyrën e shpërndarjes së votave. Diskutimi tjetër, mund të kërkoni vendimin e Komisionerit, në mos gaboj, të marsit “Për shpërndarjen e fondeve për partitë politike parlamentare”. Partia Demokratike ka qenë në koalicion PD-AN. Në marrëveshjen e koalicionit janë përcaktuar qartë se Partia Demokratike do të jetë parti drejtuese e koalicionit, por lista shumemrore e saj ka qenë e përcaktuar. Çdo parti kandidatët e vet i kishte të përcaktuar në listën shumemrore. Unë do t’ia kërkoja dhe KQZ-së marrëveshjen dhe listën e paraqitur

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

nga Partia Demokratike në 2021, ku në listën e saj është vendosur dhe përkatësia partiake e deputetit. Në bazë të asaj liste, Komisioneri ka bërë shpërndarjen e votave. Në bazë të shpërndarjes së votës, ka bërë dhe shpërndarjen e fondeve. Aty ka marrë LZHK-ja fonde, PLL merr fonde, PR merr fonde, merr PDIU-ja fonde, sepse këto parti kanë qenë në koalicion me Partinë Demokratike dhe deputetët që kanë dalë nga lista shumemrore kanë qenë të identifikuar me përkatësinë politike përkatëse. Në bazë të kësaj marrëveshjeje është bërë shpërndarja e fondeve dhe përlllogaritja e votave që ka marrë subjekti në zgjedhjet përkatëse. Ajo është një marrëveshje ligjore. Ajo sjell efektet dhe në bazë të atyre efekteve ka bërë dhe vendimmarrje Komisioneri që është një vendimmarrje totalisht e ligjshme e pa ankuar nga asnjë nga palët. Sot jemi në kushte që Komisioneri, nga vështirësia që ka sjell pranimi i një marrëveshjeje në kundërshtim me ligjin, nuk bën dot llogaritjen e votave që ka marrë secili subjekt në koalicion. Nuk e di se sa ka marrë PBDNJ! Nuk e di se sa vota ka marrë zoti Ndoka me partinë e tij, ku në veri është shumë fuqishëm dhe ka ndikim shumë të madh! Nuk e di se sa ka marrë Partia e Lirisë në zonën e Skraparit dhe këto të tjerat ku është forcë e parë! Nuk e di, sepse për këto parti nuk e di Komisioneri se si ta ndajë. Komisioneri vjen me një propozim ku thotë PBDNJ ka marrë “0” vota, zoti Ndoka me partinë e tij ka marrë “0” vota dhe të gjitha këto i ka marrë Partia e Lirisë.

Z. E. Lako: Zoti Sefa, ju lutem, pa dashur t’ju ndërpres, megjithëse ju ndërpreva! Ju jeni këtu për të dhënë argumentet tuaja, jo për të supozuar se çfarë ka menduar Komisioneri kur ka marrë atë vendim, as për të bërë një paralelizëm me zgjedhje të tjera të përgjithshme, apo me ndarjen e fondeve se si... nuk jemi për atë sot! Ju lutem, përqëndrohuni te vendimi që jemi duke shqyrtuar me argumentat që ju keni si palë për çështjen e anëtarëve të KZAZ-së, pra për këtë që po shqyrtojmë sot. Pa u ndalur

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

në procese dhe vendime të tjera që mund të jenë konflikte në të ardhmen, që mund të shqyrtohen dhe nga KAS-i. Të merremi me atë që po shqyrtojmë ju lutem, sepse ju vetë thoni që këtë vendimmarrje ka mbajtur KAS-i, ka lënë në fuqi Kolegji...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kë vendimmarrje?

Z. E. Lako: Atë që diskutuat, për sa i përket legjitimitit të palës tuaj tek ankimi tjetër. Tani në qoftë se ka marrë një vendim KAS-i dhe është lënë në fuqi nga Kolegji, tregon që ky është interpretimi ligjor që ka përcaktuar ligjvënësi, sepse interpretimin përfundimtar e bën gjykata. Është tjetër gjë se çfarë mendoj unë, apo ju si palë!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Thashë tjetër gjë! Thashë që nuk do të ishim në këto kushte...

Z. E. Lako: Nuk do të ishim, po ja që jemi, sepse është një vendimmarrje që është marrë në zbatim të ligjit, sepse organet që ka përcaktuar ligji kështu kanë vendosur.


Z. L. Braho: Të bëj një pyetje unë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ja ta mbaroj...

Z. E. Lako: Po, por të lutem, mos u shpërnda nga objekti i shqyrtimit të sotëm!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Nuk do të ishim në këto kushte...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. K. Bele: Po nuk do të ishim në këto kushte në qoftë se nuk do të ishte ndarë PD-ja, prandaj jemi në këto kushte...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo pra jo, nuk ka lidhje! Nuk do të ishim në këto kushte në rast se Komisioneri do të zbatonte ligjin.

Z. K. Bele: Nuk dua të hyj në debat, ka një vendim Kolegji, ne nuk dalim dot përtej atij vendimi të Kolegjit. Ju e përdorni si argument, është në të drejtën tuaj ta përdorni si argument. Thjesht, nuk mund t'i vijmë anash atij argumenti sikur të kishim qenë kështu, apo ashtu, megjithatë...


Z. L. Braho: Indrit, dua t'ju sqaroj diçka në lidhje me këtë! Meqenëse e lidh me regjistrimin e koalicionit për zgjedhjet e 14 majit. Ju me sa mbaj mend unë nga procesi që është bërë këtu, pretendonit që po regjistrohet një koalicion që përfshin Partinë Demokratike dhe që nuk është vullneti dhe që nuk duhet të regjistrohet. Nuk është ngritur asnjëherë pretendimi që ky koalicion pa sigla partish, në pjesën e këshillave, cënon interesat e Partisë Demokratike kur të vijë çështja për KZAZ-të, apo për lekët. Ky nuk është ngritur, sepse po të ishte ngritur ky pretendim do ta vlerësonim në atë kohë, a ka pas interes të ligjshëm Partia Demokratike, apo jo. Të njëjtën gjë do të bënte dhe Kolegji. Kjo po ngrihet për herë të parë sot...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo!

Z. L. Braho: Si jo?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo, pra! Në seancë publike me Komisionerin...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. L. Braho: Nuk di çfarë ke bërë me Komisionerin. Ne në KAS kemi shqyrtuar vetëm pjesën e pretendimit që pse Partia Demokratike është pjesë e një koalicioni që nuk ka shprehur vullnetin.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: As nuk legjitimohej si palë e interesuar në proces, çfarë po flisni?! Nuk i keni hyrë themelit fare!

Z. L. Braho: Po jo themelit, interesit të ligjshëm, pra!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po, pra!


Z. L. Braho: Ti nuk ke ngritur interesin e ligjshëm në prizmin e lekëve, apo të KZAZ-ve.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Çfarë interesi të ligjshëm në prizmin e lekëve?! Ju nuk më keni thënë që zoti Sefa...

Z. E. Lako: Zoti Sefa, ndërhyrja ishte që të fokusohemi të çështja që kemi si objekt, ju lutem pa dashur të merremi me gjëra që janë gjykuar dhe që nuk i shërbejnë kësaj çështjeje.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Fjala ime lidhej me faktin që, Komisioneri mori një vendim në zbatim të gabuar të ligjit, të cilin ne e ankimiam duke kërkuar që t'ia çonte subjekteve zgjedhore, për të bërë marrëveshje të re në zbatim të ligjit dhe pastaj të regjistronte koalicionin. Nuk na e pranoi! KAS-i nuk na legjitimoi, se tha që: “nuk mundet, sipas praktikës së KAS-it, që ju të jeni pjesë e subjektit dhe si rrjedhojë nuk

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

mund ta ankimoni”. Por nuk u muarët me argumentat tanë, nuk na legjitimuat si palë me interes të ligjshëm. Të njejtën gjë bëri dhe Kolegji, por kjo nuk do të thotë që argumentat e ngritur nga unë, nuk janë në zbatim të ligjit. Po t’i hyni themelit, keni dispozitën ligjore. Merrni marrëveshjen që ka “Bashkë Fitojmë” është posaçërisht e bërë në atë formë, me qëllim që të jemi në këtë situatë sot. Çfarë thotë pika...

Z. E. Lako: Mirë pra, ndërhyrja ka të bëjë me faktin që çfarë ju pretendoni që ka lidhje me çështjen që po gjykojmë, parashtrojeni që të mos zgjatemi me vendimmarrje që...


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Pika 7 e marrëveshjes: “Në listat shumemërore për këshilltarë të koalicionit zgjedhor duhet të përfshihen për çdo parti të koalicionit, numrit të kandidatëve dhe renditja e tyre bazuar në marrëveshjen midis palëve. Kandidatët në listat shumemërore të koalicionit, pavarësisht se cilës parti i përkasin, do të konsiderohen dhe vlerësohen si kandidatë vetëm të koalicionit, duke shmangur trajtimin e tyre sipas përkatësive partiake”. Dmth në qoftë se këta janë në këtë gjendje, pra ky koalicion, të gjithë kandidatët janë të të tre partive, në mënyrë të barabartë. Se këta nuk kanë bërë ndarje! Këta thonë “ne të tre siç i kemi, i kemi të gjithë bashkë”. Për çdo tre fitues, një e ka PL, një e ka PDK, një e ka PBDNJ.

Z. E. Lako: Pra ju pretendoni që, meqenëse ata nuk kanë bërë një ndarje, janë në mënyrë të barabartë.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po!

Z. E. Lako: Dakord! Iku kjo! Tjetër pretendim?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ky është pretendimi pra!

Z. E. Lako: Atëherë këtë pretendim mbështesni?


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Edhe llogaritja e votave, në bazë të mandateve të përfituara, në mënyrë të barabartë. Të pjestohet me tre, të dalin mandatet për secilën parti, të bëhet llogaritja në bazë të numrit të votave. Siç ka bërë gjithmonë ky komision zgjedhor. Edhe Komisioneri kur ndan fondet, në këtë mënyrë vepron. Merr mandatet që ka marrë PLL, në koalicion me PD, bën llogaritjen për mandat se sa vota i takon mandatit, e shumëzon me vlerën për votë, nxjerr vlerën përkatëse për secilën parti. Kjo është formula. Duhet të përcaktohet se sa mandate ka marrë. Subjekti “Bashkë Fitojmë”, nuk ekziston më. Nuk ka më as personalitet juridik, nuk ka asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor në të cilën mund të referohet sot Komisioneri për të marrë një vendimmarrje për këtë.

Z. E. Lako: Pra, e thënë shkurtimisht, ju pretendoni që votat që ka marrë ky koalicion të pjestohen me tre dhe secili nga ato subjekte ka atë numër votash që përkthehet në “x” mandate. Me këtë logjikë ju dilni parti e parë opozitare dhe ju takojnë dy anëtarë në KZAZ. Pak a shumë kjo është ajo që kërkoni. Dakord! Tjetër gjë keni për momentin?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo nuk kam për momentin!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Sefa! Nga anëtarët e KAS-it ka ndonjë pyetje? Po zoti Rusmali!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 6.09.2023

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Unë kam një pyetje, së pari për Sekretarin e Përgjithshëm, për administratën e KQZ-së. Në vendimin e Komisionerit lexohet që “Për të përcaktuar raportet shumicë-opozitë parlamentare, Komisioneri i është referuar një shkresë të ardhur nga Kuvendi, diku nga janari 2022. Ju si administratë e keni ndjerë nevojën për aktualizimin e këtij informacioni, apo mendoni se nuk ka nevojë të aktualizohet, mjafton informacioni i 2022, për të përcaktuar raportet shumicë-opozitë?”


Z. Y. Merkaj: Duke qenë se bëhet fjalë për përbërjen e Kuvendit, partitë parlamentare pjesëmarrëse në Kuvend, nuk ka ndryshuar situata. Ne e kemi marrë të mirqenë shkresën e datës 24 janar 2022 të ardhur nga Kuvendi në lidhje me raportin pozitë-opozitë, ose shumicë-pakicë parlamentare.

Z. I. Rusmali: Dakord! Nuk ka ngjarje politike të mëvonshme që të kenë ndryshuar situatën, thoni ju. Kështu që dokumenti është i vlefshëm edhe sot e kësaj dite. Një pyetje për ankuesin. Mund të na thoni sot, nga informacioni që keni ju, sa këshilltarë keni ju në rang Shqipërie?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ky është informacion i çuditshëm me thënë të drejtën. Ka ndodhur diçka që disa nga këshilltarët që kanë dalë nga ky subjekt “Bashkë Fitojmë”, janë prezantuar si përfaqësues të Partisë Demokratike...

Z. I. Rusmali: Jo, nuk po ju kërkoj ende informacion për të tjerët, po kërkoj për ju si parti.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 6.09.2023

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Numri që na ka nxjerrë KQZ-ja nuk pasqyron të vërtetën po them, sepse..

Z. I. Rusmali: Na thuaj njëherë numrin që ka nxjerrë KQZ-ja, pastaj na thuaj modifikimet.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: 127, në mos gaboj!

Z. I. Rusmali: 127 këshilltarë në rang Shqipërie. Mund ta konfirmojmë saktësisht këtë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Duhet të marr vendimin e KQZ-së! E ka KQZ-ja shpërndarjen e mandateve.


Z. I. Rusmali: Ju na e konfirmoni dot numrin?

Z. Y. Merkaj: Na duhet pak kohë.

Z. I. Rusmali: Dakord! Ka mundësi të jetë 123! Dakord 123, ose 127! Ndërkohë cila është pasqyra sot?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ja po ju them, në këshillin bashkiak Durrës ka grup këshilltarësh të Partisë Demokratike, ka dhe grup këshilltarësh demokratë. Ka grup këshilltarësh Partia Lirisë, ka grup këshilltarësh të djathtë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. I. Rusmali: Të lutem, ata që ke ti sa janë? Kërkojmë grigjën tënde, të tutë sa janë?
Të janë shtuar...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po!

Z. I. Rusmali:.. apo të kanë ikur?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Grupi i këshilltarëve vendorë në Lezhë ka marrë dy nga subjekti Bashkë Fitojmë që janë pjesë e grupit të këshilltarëve bashkiakë të Partisë Demokratike. Madje ka mbetur Partia e Lirisë me ata që ka të saj. E njejtat gjë në Laç.., dmth ky është një fenomen në të gjithë Shqipërinë. Edhe në Tiranë e njejtat gjë... madje edhe në Tiranë...

Z. I. Rusmali: Statistikë aktuale keni?


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo pra, se është e përditshme kjo gjë ..

Z. I. Rusmali: Ndryshon çdo ditë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Në Këshillin Bashkiak Durrës kemi dy grupe që thotë “grupi i këshilltarëve bashkiakë të Partisë Demokratike” dhe “grupi i këshilltarëve të djathtë”, dmth demokratë.

Z. I. Rusmali: Dakord! Grupi i këshilltarëve bashkiakë të Partisë Demokratike në Bashkinë e Durrësit, sa anëtarë ka?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Në mos gaboju pesë! Duhet ta verifikojmë!

Z. I. Rusmali: Pesë! Kaq ka pas, pas zgjedhjeve?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po kaq!

Z. I. Rusmali: Mund ta marrim këtë, që të kemi një përgjigje të saktë bashki për bashki? Ju mund të na e jepni?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Duhet të kërkoj informacion! Nuk e kam informacionin se duhet t'ju nis me shkresë zyrtare bashkive në të gjithë Shqipërinë.

Z. I. Rusmali: Janë të tutë ata, ti ke raport me të gjithë këshilltarët e tu?


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po pra, por duhet të vijë përgjigje zyrtare nga këshillat bashkiakë.

Z. I. Rusmali: Jo nuk e dua nga këshillat bashkiakë, nga partia, nga selia qendrore. Ti si parti sa njerëz ke? Sa pushtetarë ke në rrethe sot? Sot në këtë orë që jemi në të mbledhur këtu, sa këshilltarë bashkiakë, subjekti juaj disponon në të gjithë Shqipërinë? E keni informacionin apo nuk e keni? Nuk e dua nga këshillat, e dua nga ju si subjekt!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Informacionin t'ju jap në mënyrë jo zyrtare?!

Z. I. Rusmali: Jo more zyrtare, pse ku jemi këtu, në pazar?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po si ta marr unë tani?! .

Z. I. Rusmali: Dakord! Na e siguron dot informacionin zyrtar nga Partia Demokratike, sa këshilltarë ka bashki për bashki?


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po!

Z. I. Rusmali: Dakord, faleminderit!

Z. E. Lako: Nga kolegët, ka dikush tjetër?

Z. K. Bele: Po kam unë një pyetje! Kërkova dhe vendimet në fakt, por në kujtesën time në zgjedhjet e mëparshme, duke qenë se formula për përcaktimin e KZAZ-së nuk ka ndryshuar që nga ndryshimet e Kodit Zgjedhor të 2020, që nga 2012 është e njejta formulë praktikisht. Ka pas raste që subjektet si pozitë dhe opozitë kanë hyrë me koalicione. Pra, në kujtesën time edhe në zgjedhjet e mëparshme në 2015, 2019 se kujtoj tamam, por do shohim vendimet, kjo praktikë mund të na.. meqenëse ju jeni këtu prej shumë vitesh në këtë detyrë. Praktika e ndarjes së numrit të këshilltarëve si është zbatuar? Si është përkthyer rezultati i koalicionit në zgjedhjet pasardhëse të 2015, 2019, kur kanë qenë.., bëhet fjalë për zgjedhjet vendore gjithmonë? Shohim që në vendimin e Komisionerit nuk ka një arsyetim, por ka një përkthim duke thënë “Bashkimi për Fitore” 108.000 vota, parti e parë opozitare, është përkthyer direkt te partia udhëheqëse e koalicionit. A është kjo praktikë e mbajtur në vendimmarrjet e mëparshme të Komisionerit?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. Y. Merkaj: Këtë praktikë kemi mbajtur. Partia udhëheqëse e koalicionit ka qenë partia që ka marrë të gjitha të drejtat dhe detyrimet në zgjedhjet pasardhëse, ose të pjesshme.

Z. K. Bele: Pra, ju thoni që kjo është praktikë standarde e KQZ-së?

Z. Y. Merkaj: E ka mbajtur këtë praktikë.

Z. K. Bele: Komisioneri, ose KQZ-ja në formatin e dikurshëm si organ kolegjal, në vendimmarjen e themelit, kompetencë që sot e ka Komisioneri, ka ndarë dhe në zgjedhjet e mëparshme, sipas një formule, numrin e anëtarëve të KZAZ-së. A është kjo standardi, apo është...


Z. Y. Merkaj: Historikisht, partia e opozitës parlamentare ka qenë..., kur ka qenë PD-ja në opozitë, ka pas të drejtën si parti kryesore e opozitës, të propozojë dy anëtarë në KZAZ. Gjithashtu kjo parti ka qenë gjithmonë parti udhëheqëse e koalicioneve. E njejtja gjë ka qenë dhe në anën tjetër me PS-në, ka qenë drejtuese e koalicionit, ka pas të drejtën të propozojë anëtarë si parti kryesore e opozitës.

Z. K. Bele: Pra, është barazuar partia udhëheqëse me të drejtën e koalicionit për të marrë dy, apo tre anëtarë të KZAZ-së?

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. K. Bele: Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 6.09.2023

Z. Y. Merkaj: Në të gjitha zgjedhjet historikisht, ka qenë PS dhe PD që kanë propozuar anëtarët kryesorë dy dhe dy.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kam një pyetje për...


Z. E. Lako: Të mbarojnë anëtarët e KAS-it dhe pastaj do të kalojmë dhe te ju! Zoti Rusmali kishit..? Po!

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Unë kam një kërkesë për administratën e KQZ-së për marrjen e një prove. Na duhet informacion nga 61 këshillat bashkiakë që ka Shqipëria, lidhur me... Ta filloj pak ndryshe, në fillim të mandatit këshillat bashkiakë kostitohen, formojnë organet e tyre drejtuese, ndahen në grupe këshilltarësh, (këshilltarët). Aty kuptohet cilat janë grupet politike dhe cilët janë këshilltarët e pavarur, sepse ka dhe nga ata që janë të painkuadruar. Për këtë çështje, unë mendoj se ka rëndësi të kuptojmë, cili ka qenë formimi i këshillave bashkiakë në momentin e kostituimit. Në mënyrë të veçantë informacioni për subjektin Partia Demokratike e Shqipërisë dhe për subjektin Partia e Lirisë, na duhet i saktë. Të tjerat edhe mund të mos i kemi nuk janë domethënëse për çështjen. Eventualisht e plotësuar kërkesa edhe me përgjigjen për situatën aktuale. Sot cili është ky konfigurim, meqenëse ankuesi thotë që konfigurimi ndryshon nga dita në ditë. Mund të na e siguron këtë informacion nga këshillat bashkiakë, që ne të mund të gjykojmë pastaj mbi çështjen?

Z. Y. Merkaj: Patjetër, do të komunikojmë, po nuk di afatin se kur mundet ti kemi.

Z. I. Rusmali: Brenda ditës së sotme!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. Y. Merkaj: Po, do të përpiqemi.

Z. I. Rusmali: KAS-i mund të marrë vendim si ta gjykojë KAS-i, po për aq sa më takon mua, ky është informacion shumë i rëndësishëm për çështjen. Unë vetë nuk jam në gjendje të marr vendim, nqs nuk e disponoj këtë informacion. Kështu që unë kërkoj pezullimin e shqyrtimit deri sa të na jepet informacioni.

Z. E. Lako: Zoti Merkaj, sa kohë mund t'ju duhet për ta marrë këtë informacion?

Z. Y. Merkaj: Nuk mund t'ju jap një afat të saktë. Do të bëjmë maksimumin, do ta fillojmë punën që tani.

Z. E. Lako: Bëhet fjalë për një orë, dy orë, brenda ditës së sotme?

Z. Y. Merkaj: Të paktën tre orë po, na duhen! Nuk e di, mund të duhet edhe më pak kohë por që të jemi...

Z. L. Braho: Unë kam një dilemë për këtë, sepse fakti që dhe vetë ankuesi e pranon që këto këshillat janë të ndryshueshëm dhe ne... momenti që njeh ligji është momenti kur kanë kandiduar, për kë kanë kandiduar. Tani është fakt që këta nuk janë përcaktuar nëpër lista se kandidat të cilës parti kanë qenë, këta të koalicionit. Nuk e di se sa ky informacion na zëvendëson ne pjesën e listave. Sot mund të ketë dhe këshilltarë që kanë qenë te listat e opozitës dhe mund të kenë kaluar te grupet e Partisë Socialiste. Kjo nuk ndikon as te raporti i KZAZ-së dhe as të pjesa e financimit të zgjedhjeve, ai është për momentin e kandidimit. Argumenti që subjekti zgjedhor nuk ekziston më, nuk bëhet fjalë që subjekti zgjedhor, absolutisht që nuk ekziston

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

tani, por dhe lekët që paguhen sa i përket financimit të zgjedhjeve, paguhen për ato zgjedhje që ka pas personalitet juridik. Në qoftë se ne do të shohim se si janë këshilltarët sot, numrat mund të kenë lëvizur krejtësisht, por kjo nuk i bën ata kandidatë të një partie apo të një partie tjetër.

Z. I. Rusmali: Dakord! Unë nuk jam duke arsyetuar rreth gjyqimit që do të bëjë KAS-i. Unë jam duke kërkuar informacion që duhet ta kemi përpara se të gjykojmë mbi gjërat. Informacioni është ai që është, është neutral rreth çështjes, por informacioni duhet për të kuptuar me kë kemi të bëjmë, duhet të dijmë se kë kemi përpara me gjithë konturin e vet. Pastaj nëse ka vlerë themelore për gjykimin, apo ka vlerë anësore për gjykimin, apo është irrelevant për gjykimin ose gjykimi duhet bazuar në të kundërtën e tij. Kjo është histori tjetër, kjo është çështje e dhomës së këshillimit. Unë insisto që ky informacion duhet të jetë i disponueshëm për ne përpara se ne të vendosim. Për këtë arsye do të ftoja dhe kolegët që ta marrin në konsideratë edhe mundësinë e pezullimit të shqyrtimit deri sa të na sigurohet informacioni.


Z. E. Lako: E marrim dot deri në orën 15:00, të paktën pjesën e kostituimit?

Z. Y. Merkaj: Besoj se po!

Z. E. Lako: Po zoti Sefa!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Në të gjithë këshillat bashkiakë, këshilltari vetdeklarohet se i kujt subjekti është. Kjo procedurë besoj se është kryer nga të gjithë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

këshilltarët. Në qoftë se informacioni është se sa këshilltarë janë deklaruar si të Partisë Demokratike dhe sa si të Partisë së Lirisë, besoj se është e qartë.

Z. L. Braho: Zoti Sefa, meqenëse dhe ju vetë thatë që është çështje vetdeklarimi. Ju si përfaqësues i Partisë Demokratike, jeni dakord që në bazë të vetdeklarimeve të quani si mandate tuaja edhe ato që nuk kanë qenë pjesë e listës së Partisë Demokratike? Pra, sa komod jeni me këtë pjesë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Te ndërgjegjia e qytetarit se si vetdeklarohet, unë nuk ndërhyj dot, në qoftë se grupi i këshilltarëve demokratë ndjehet i Partisë Demokratike, mirë se të vijë.

Z. L. Braho: Pra, jeni dakord që edhe kandidatë nga listat e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, nëse janë vetdeklaruar si të Partisë Demokratike ju jeni të gatshëm t’i pranoni në gjirin e Partisë Demokratike dhe të merrni edhe lekët në këmbim të vetdeklarimit të tyre, për efekt të fushatës zgjedhore, apo jo?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Votat e Partisë Demokratike, ne themi që të gjitha llogaritjet bëhen në bazë të votave, po në qoftë se duan njerëz të vijnë në Partinë Demokratike, janë të mirëpritur, mjafton të mos jenë në bunkerë antiamerikan. Të tjerët pastaj, pranohen të gjithë.

Z. E. Lako: Mirë, meqenëse u kërkua ky informacion nga zoti Rusmali, dhe KAS-i patjetër që e mbështet këtë kërkesë. Administrata mori përsipër që ta sjellë këtë informacion për një afat diku te tre orë dhe pala ankuese është dakord me këtë, atëherë e ndërpresim seancën këtu, për ta riçelur përsëri në orën 15:00, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*


Rifillon seanca

Ora 15:19

Z. E. Lako: Riçelim dhe njëherë shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr.93, depozituar në datën 20.09.2023, ankues subjekti zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë. E ndërpreme seancën në lidhje me marrjen e një informacioni nga bashkitë për mënyrën e ndarjes së mandateve sipas subjekteve zgjedhorë. Nga administrata e KQZ-së na është vënë në dispozicion, pak më parë një informacion në lidhje me mandatet që kanë marrë në secilën bashki të vendit në këto zgjedhje. Ju lutem, zoti Merkaj, na bëni shkurtimisht një shpjegim të këtyre shifrave që na keni vënë në dispozicion.

Z. Y. Merkaj: Fillimisht dua t'ju bëj me dije që informacioni është marrë në rrugë telefonike, nga ora 12:30 dhe më pas. Disa nga kryetarët e këshillave bashkiakë që kemi komunikuar janë shprehur se ky informacion nuk është ligjor. Nuk kemi të parashikuar në ligj që anëtarët e këshillit bashkiak të vetdeklarojnë përkatësinë politike, kështu që informacioni është çfarë është bërë në mbledhjen e parë dhe se çfarë kanë vetdeklaruar anëtarët e këshillit bashkiak. Kryesisht kemi pyetur se si janë ndarë mandatet në Koalicionin “Bashkë Fitojmë”. Psh për të pasqyruar këtë që thashë. Në Qarkun berat, Bashkia Berat këshilltarët kanë deklaruar se jemi tre anëtarë të Partisë së Lirisë, brenda Koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Katër anëtarët e tjerë, pretendojnë se janë të Partisë Demokratike, e cila është e zotit Berisha. Këta katër anëtarët nuk kanë qenë subjekt zgjedhor, kështu që nuk e di se si ta shpjegoj se kujt i takojnë këta...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: I nderuar zoti Sekretar i Përgjithshëm...

Z. E. Lako: Të mbarojë njëherë...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo, jo, kam nevojë të bëj një ndërhyrje

Z. E. Lako: Patjetër, por të mbarojë njëherë atë... e pastaj do të keni gjithë kohën në dispozicion për të bërë pyetje dhe sqarime.

Z. Y. Merkaj: Të pyetur dhe anëtarët e Partisë Demokratike për zgjedhjet e 14 majit janë 123 mandate në të gjithë Shqipërinë.

Z. E. Lako: Po të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”?

Z. Y. Merkaj: Të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” i kemi të gjitha bashkë.

Z. E. Lako: Sa janë bashkë?


Z. Y. Merkaj: Janë më shumë se 123, për pak do të kemi informacionin e saktë!

Z. I. Rusmali: Të bëj një pyetje unë?

Z. E. Lako: Po zoti Rusmali!

Z. I. Rusmali: Në Gjirokastrë, Dropull sipas informacionit tuaj është një këshilltar nga PD dhe dy të tjerë nga kush janë?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. Y. Merkaj: Nga PBDNJ!

Z. I. Rusmali: Do të thotë që nga Partia e Lirisë nuk ka! Dakord! Nga lista që ju del ju këtu...

Z. Y. Merkaj: Një është nga PD-ja e foltores dhe dy janë të PBDNJ!

Z. I. Rusmali: Si e dalloni ju që janë të PD-së së foltores?

Z. Y. Merkaj: Sepse pretendohet që kanë qenë Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, pavarësisht se nuk është regjistruar si subjekt zgjedhor.

Z. I. Rusmali: Dakord! Nga informacioni që keni marrë, mund të na thoni Partia Demokratike e Shqipërisë, jo grupimi i rithemelimit, por Partia Demokratike e Shqipërisë, sa këshilltarë ka? Nga lista që na keni dhënë totali na del 123!


Z. Y. Merkaj: Po 123 janë!

Z. I. Rusmali: Janë të gjithë të Partisë Demokratike të Shqipërisë, apo janë ngatërruar?

Z. Y. Merkaj: Po! Më 14 maj janë të gjithë të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Ndërsa Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ka 292 mandate.

Z. I. Rusmali: Nuk më duhet koalicioni... këshilltarë të Partisë së Lirisë të deklaruar në kostituimin e këshillave, sa janë?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. Y. Merkaj: Nuk mund ta jap dot informacionin e saktë, sepse nuk e kam marrë të gjithë informacionin nga këshillat bashkiakë.

Z. I. Rusmali: Nga sa e kemi këtë informacion që na keni dhënë ne?

Z. Y. Merkaj: E kemi nga 57 – 58 këshilla bashkiakë.

Z. I. Rusmali: Dakord, duhet ta bëjmë 61.

Z. Y. Merkaj: Po, duhet të presim të 61 informacionet që të kemi një shifër të saktë.

Z. I. Rusmali: Nga këto 58 këshilla, sa është totali, është 90?

Z. Y. Merkaj: Na duhet kohë t'i mbledhim.


Z. I. Rusmali: Na e bëni mbledhjen e na thoni sa është për 58 e pastaj e çojmë në 61, por na thoni njëherë për 58!

Z. E. Lako: 292 mandate kishte koalicioni?

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. E. Lako: Nga kolegët ka njeri tjetër pyetje? S'ka! Zoti Sefa kishit ndonjë gjë? Po, fjala për ju!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 6.09.2023

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kisha dhe në respekt të ligjit, por dhe në respekt të subjektit zgjedhor dhe përfaqësuesve të Partisë Demokratike, ju lutem administratës së KQZ-së, të mos i referohet si PD-ja e “filanit” dhe si e “fistekut”. Partia Demokratike e Shqipërisë është një subjekt zgjedhor, parti politike dhe nuk ka përcaktime të tjera përveç kësaj. Në rast se ka persona që pretendojnë se kanë parti imagjinare të gjejnë emrin dhe t’i referohen. Së dyti, është e qartë që ndarja e anëtarëve të këshillave bashkiakë në kostituimin e tyre është bërë e qartë përfaqësimi i Partisë së Lirisë.


Z. I. Rusmali: Këtë se themi dot!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: A janë shprehur vetë ata?

Z. I. Rusmali: Ne mund të themi me siguri që nëse KQZ-ja në shpalljen e rezultatit përfundimtar ka kalkuluar 123 këshilltarë në rang kombëtar për Partinë Demokratike, në fakt në kostituimin e këshillave janë 123 këshilltarë të PD-së në rang kombëtar për Partinë Demokratike. Kaq mund të konfirmojmë deri tani. Ke ndonjë bazë tjetër të dhënash që mund të na konfirmosh Partinë e Lirisë? Në qoftë se ti thua nga kjo lista, kësaj liste nuk i doli zot, zoti Merkaj. Tha që ka nevojë për më shumë kohë për të ndarë Partinë e lirisë. Ke ti të dhëna të mjaftueshme që të na ndihmojnë për të ndarë se sa këshilltarë ka Partia e Lirisë në kostituim?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: I nderuar edhe si pasojë e kohës, unë nuk kam pas mundësi të çoj shkresa zyrtare këshillave bashkiakë për të marrë këtë informacion, por kjo është një detyrë që duhet ta bënte Komisioneri në momentin e përcaktimit dhe të vendimmarrjes. Nuk mund ta bëjmë ne si subjekt zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. I. Rusmali: Zoti Sefa, Ju keni parti kapilare! Sa këshilltarë ka nga ky informacioni partiak? Keni njerëzit tuaj, keni informacion politik.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Atë e di unë...

Z. I. Rusmali: Sa këshilltarë ka?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Në të gjithë Shqipërinë?

Z. I. Rusmali: Po!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Duhet të jenë më pak se 111, besoj se po!
(diskutim pa mikrofon)

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Sa këshilltarë janë që ndihen si të lirë si këta të Partisë së Lirisë...


Z. E. Lako: Mirë, ajo kuptohet sepse këshilltarët kanë emra dhe kanë qenë në listat e subjektit, në rastin konkret të koalicionit. Pavarësisht se si deklarohen ata të kujt grupimi, ata janë të koalicionit.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo pra, s'ka më koalicion!

Z. E. Lako: Në momentin e kostituimit dhe në momentin kur janë dorëzuar listat...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Duhet të përcaktohej përkatësia politike!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. E. Lako: E qartë, por ata janë në listat e koalicionit. Ne po themi këta si ndihen mbrapa.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo, jo, ai ka shkuar në këshill dhe thotë “mua te kjo lista më ka futur PL dhe thotë jam i PL”. Ai është në të drejtën e tij, ka bërë veprimin ligjor që duhet të bëjë, pavarësisht se dalin të tjerë në llogaritje. Por ai thotë “mua më ka futur PL te kjo listë dhe jam i PL”.

Z. E. Lako: Pavarësisht kësaj ne po themi cila është gjendja faktike?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Zyrtarisht e marrim nga këshillat bashkiakë. KQZ-ja ka të gjithë informacionin dhe mundësinë për ta marrë.


Z. I. Rusmali: Ju duhet të vini këtu e të na thoni: Partia e Lirisë ka “kaq” këshilltarë. Sali Berisha ka “kaq” këshilltarë, Partia Socialiste ka “kaq” këshilltarë.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Për informacion, unë kam ardhur për të goditur vendimmarrjen e KQZ-së, të Komisionerit për mënyrën se si e ka bërë llogaritjen, duke i kërkuar të zbatojë dispozitat ligjore...

Z. I. Rusmali: Dhe keni kërkuar pjestimin me tre?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po, për sa kohë koalicioni brenda... dakord... unë po them që Komisioneri të bëjë llogaritjen sipas dispozitave të ligjit. Të gjejë sa vota ka Partia e Lirisë, në qoftë se ka më shumë se Partia Demokratike le ta marrë! Jam i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

hapur unë për atë punë! Pastaj në qoftë se partitë brenda koalicionit nuk i ndajnë vetë në mënyrë proporcionale kush përfaqësohet? Sa? Nuk është faji im.

Z. I. Rusmali: Kemi arritur pas tre orësh në pikën që, të lutem zoti Sefa se e kam vetëm me ty! Kemi arritur pas tre orësh në pikën që ju hiqni dorë nga pretendimi që pjestimi i votave të koalicionit “BF”, duhet të bëhet me tre dhe bini dakord që kalkulimi i forcës politike të anëtarëve të koalicionit të bëhet mbi bazën e mandateve që disponohet në këshillat vendore. Këtë na the tani?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo?


Z. I. Rusmali: Nuk na the këtë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo!

Z. I. Rusmali: Ma kundërshto të lutem!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Sapo thashë, mënyra e vendimmarrjes së Komisionerit nuk është e bazuar në ligj, sepse marrëveshja duhet të ketë përkatësinë politike. Kur janë lista shumemërore të kandidatit. Marrëveshja në vetvehte, thashë, është bërë e qëllimshme, ku të gjithë kandidatët quhen të subjektit zgjedhor, që ishte Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, i cili nuk ka personalitet juridik dhe si i tillë shkrihet. Nuk mund të jenë kandidatët të një subjekti që nuk ekziston, e para. E dyta, thashë “Komisioneri duhet të gjejë sa mandate ka Partia e Lirisë në këshillat vendorë, pasi t’i kostitujë të shohë sa mandate ka! Nxirret vota për mandat... duhet ta bëjë Komisioneri...”

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. I. Rusmali: Të lutem, pjestimi me tre nuk ekziston në marrëveshje.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: I ka quajtur të gjitha partitë të barabarta!

Z. I. Rusmali: Dakord! Pra, kërkesa juaj që KAS-i të bëjë pjestimin me tre, ju e tërhiqni?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo nuk tërheq gjë unë!

Z. I. Rusmali: Doni pjestimin me tre?!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Unë dua që Komisioneri të përcaktojë sa vota ka PL!

Z. I. Rusmali: Dakord, ju doni që Komisioneri të gjejë mandatet?


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo, unë dua që Komisioneri të gjejë se sa vota ka PL-ja! E bën me tre, e bën pa tre, unë nuk i hyj çështjes!

Z. I. Rusmali: Ju thatë që Komisioneri të gjejë sa mandate ka Partia e Lirisë...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Është një formë për të gjetur numrin e votave...

Z. I. Rusmali: Të lutem, sepse ose kërkojmë të orientohemi nga mandatet, ose kërkojmë që të zbatohet kriteri i Komisionerit që të gjitha votat i merr partia udhëheqëse, sepse pjestimi me tre është fantazi, nuk ekziston me asnjë kriter. S'është

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

në ligj nuk është në marrëveshje. S'është asgjëkundi! Tani heq dorë nga pjesëtimi me tre dhe kërkon sipas mandateve, apo çfarë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po ju them dhe besoj se jam i qartë te kjo pjesë. Komisioneri mënyrën e nxjerrjes së votës, unë dua nga Komisioneri të më nxjerri sesa vota ka PL, sesi e bën Komisioneri për llogaritjen sesa vota ka marrë PL është detyrë e Komisionerit dhe nuk është e imja. Unë po them mënyrën se si e ka bërë Komisioneri në 2021 për përcaktimin e partive politike nga lista PD-AN, ka marrë mandatet e partive që janë koalicion me Partinë Demokratike...

Z. I. Rusmali: E ka këtë mundësi ta bëjë sot?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po, patjetër!

Z. I. Rusmali: Si mund ta bëjë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: T'i drejtohet këshillava bashkiakë sa janë të PL...

Z. I. Rusmali: Pra, në bazë të mandateve, jo pjesëtim me tre?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Edhe njëherë unë kërkoj pjesëtim me tre se më intereson mua kjo nuk diskutohet, po ai të bëjë ca thotë ligji.

Z. I. Rusmali: Do të thotë që po kërkon gjithashtu që Komisioneri të kërkojë mandatet.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. I. Rusmali: Pra, heq dorë nga pjesëtimi me tre?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Është një nga format për të nxjerrë numrin.

Z. E. Lako: Zoti Sefa, tani se çfarë do të bëjë Komisioneri...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Komisioneri do ta pjesëtojë me tre dhe kaq, mirupafshim.

Z. E. Lako: Z. Sefa atë që po ju thonë kolegët është që...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Nuk heq dorë nga kërkesa...

Z. E. Lako: .. se çfarë ka bërë dhe do të bëjë Komisioneri e di vetë Komisioneri. Ai e ka bërë atë që di...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo, nuk ka bërë gjë.

Z. E. Lako: Ai mënyrën e tij., se si interpreton ai ligjin e ka bërë. Tani ne po kërkojmë nga ju, më falni, pse e kundërshtoni dhe çfarë argumentash keni? Se çfarë ka bërë Komisioneri e di vetë ai, ndaj e ka bërë!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Komisioneri ka nxjerrë një vendim ku ka llogaritur numrin e votave të një subjekti që nuk ekziston më, ka llogaritur fondin për një subjekt që nuk ekziston më.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. I. Rusmali: Më falni të bëj një pyetje! Ne kemi nevojë ta dimë këtë gjë, ne nuk po diskutojmë kot. Kemi nevojë të dimë qëndrimin e Partisë Demokratike, lidhur me mekanizmin e kalkulimit të forcës politike në bazë të mandatit. Ju jeni pro që kalkulimi i PL të bëhet në bazë të mandatit apo jeni kundër?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Dakord në bazë të mandateve llogaritet, kaq.

Z. I. Rusmali: Ju jeni pro që kalkulimi i forcës politike të partisë të bëhet në bazë të mandateve që ka në bazë. Do të thotë hiqni dorë që të bëhet duke pjesëtuar me tre? Nuk hiqni dorë?!


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Edhe njëherë! Nuk dua të heq dorë, më rrëzo këtë kërkesë, prano tjetrën, nuk dua të heq dorë nga kjo kërkesë. Nuk dua!

Z. L. Braho: Nuk bëhen të dyja.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Nëse Komisioneri thotë nuk e llogaris dot me mandate unë, pse të rrëzoj kërkesën unë! Në bazë të ligjit dhe në bazë të procedurës së mëparshme merr mandatin subjekti, nxirret vota për çdo mandat, llogaritet, kaq.

Z. I. Rusmali: Siç na e tha zoti Sefa, ai është dakord që kalkulimi të bëhet edhe mbi bazë të mandateve pa e ditur se si janë ndarë mandatet dhe kjo është e drejtë. Ai e mbështet këtë kërkesë. Ne mund ta dëgjojmë ta thotë përfundimisht, por informacioni është provë që neve na serviret edhe në dhomë këshillimi. Nuk kemi pse ta mbajmë të hapur seancën për të marrë informacionin përfundimtar.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. E. Lako: Ne këtë informacion e kemi marrë, por vetëm nuk kemi shifrën përfundimtare konkrete që të jetë e certifikuar.

Z. Y. Merkaj: Problemi është se në disa bashki nuk janë ndarë, nuk deklarojnë që janë të PL apo PBDNJ, por deklarojnë se janë të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Janë të paktën 2-3 bashki që e pretendojnë këtë. Përsëri nuk e ndajmë dot këtë pjesë.

Z. K. Bele: Është në të drejtën e tyre të deklarojnë.

Z. I. Rusmali: Dakord! Jemi grup parlamentar i “Bashkë Fitojmë”, dakord! Ne na duhet informacion sa janë PD, sa janë PL!


Z. Y. Merkaj: Po të marrim shembullin e Tiranës, “Bashkë Fitojmë” ka 15 mandate, PD ka 4 mandate dhe mandatet e tjera janë PR dhe PBDNJ. Ideja është që këto 15 mandatet e “Bashkë Fitojmë” këta i kanë ndarë.

Z. I. Rusmali: Dakord! Por të na japin statistikën e saktë.

Z. K. Bele: Ylli mesa po kuptoj i zgjedhuri vendor në momentin që merr mandatin ka të drejtën të deklarojë lirisht përkatësinë partiake, pra ai mund të jetë me partinë që e ka proppzuar apo me koalicionin? Mund të jetë me një parti tjetër, mund të jetë i pavarur apo mund të asociohet me një parti kot po themi psh të gjelbërit, që mendon ai se është? Pra, kjo është ajo që ne.. dakord!

Z. E. Lako: Mirë që mos ta zgjasim më besoj se jemi të qartë, nuk kemi provë tjetër për të marrë. Shkurtimisht edhe njëherë pavarësisht se u thanë këtu zoti Sefa çfarë kërkoni nga KAS-i, ju lutem shkurtimisht!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Llogaritjen e numrit të votave të subjektit politik Partia e Lirisë dhe duke marrë në konsideratë edhe praktikën e ngjashme që është bërë më subjektin zgjedhor PD-AN, kur u ndanë edhe.. sikurse bëhet vit për vit për llogaritja e votave të çdo subjekti për efekt të shpërndarjes së fondeve të buxhetit të shtetit. Në këtë formë duhet të zbatojë Komisioneri dhe në këtë rast dhe KAS-i. Ajo bëhet në bazë të llogaritjes së mandateve.

Z. E. Lako: Komisioneri e ka kryer punën e tij. Çfarë kërkon nga KAS-i?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Llogaritjen e votave të subjektit..

Z. E. Lako: Me qëllim që të ndryshoni vendimin e Komisionerit duke përfutur ju dy anëtarë të KZAZ?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po, patjetër.

Z. E. Lako: Mirë, faleminderit!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ne pretendojmë se ka më pak vota se PD. PL ka më pak vota, na takojnë neve komisionerët.

Z. E. Lako: E kuptuam logjikën, Mirë zoti Merkaj!

Z. Y. Merkaj: Lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit, vendimi është i rregullt, pasi partia udhëheqëse e koalicionit ka qenë Partia e Lirisë. Të gjitha të drejtat dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 6.09.2023*

detyrimet përmbushen nga kjo parti, kështu që i takon kësaj partie të propozojë dy anëtarë të KZAZ nr. 11.


Z. E. Lako: Faleminderit zoti Merkaj! KAS do të tërhiqet për vendim. Besoj për të marrë edhe këtë informacionin që kërkuam. Për rreth 40 min, nëse do të vijë më shpejt mblidhemi. Do t'ju njoftojmë për të shpallur vendimin. Faleminderit.

Rifillon seanca

Ora 16:00

Z. E. Lako: Riçelim seancën. Meqenëse nga ana e administratës nuk na është vënë në dispozicion shifra për ndarjen e mandateve dhe është kërkuar kohë për të gjetur këtë shifër, shpalljen e vendimit do ta bëjmë nesër në datën 7.09.2023, ora 12:00. Të paktën rreth orës 11:00, pra një orë para fillimit të seancës të na vihet në dispozicion të KAS-it kjo shifër. Mirë me kaq e deklarojmë të mbyllur seancën për sot, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



6.09.2023
Ora 14:40

RENDI I DITËS

"Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 94, datë 5.09.2023 të
depozituar nga partia politike "Partia Demokratike (Sali Berisha)".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. E. Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali,
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj, z. M. Bardhi.
- **Parti Politike:** PDSH (z. I. Sefa), PD (z. F. Nuri)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve! Deklarojmë të hapur seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore me nr. 94, dt. 5.09.2023, drejtuar KAS-it nga subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt ankimi "Kundërshtimin e vendimit të KSHZ nr. 745, datë 4.09.2023 dhe ndryshimin e këtij vendimi duke vendosur regjistrimin PDSH, të përfaqësuar nga kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24.09.2023". Sipas shortit të hedhur në KQZ, relator i kësaj çështje jam caktuar unë, anëtari Elvis Çefa. Verifikojmë fillimisht prezencën! Është prezent trupa e plotë e KAS-it, është prezent përfaqësuesi i palës ankuese zoti:

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Franci Nuri, prezent!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.09.2023*

Z. E. Çefa: Është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ dhe stafi i administratës së KQZ-së. Rezulton se është paraqitur një kërkesë nga zoti Indrit Sefa, i cili përfaqëson gjithashtu, Partinë Demokratike të Shqipërisë dhe kërkon ndërhyrjen si palë e interesuar në shqyrtimin e ankesës të datës 6 shtator 2023, të paraqitur në KAS. Është prezent në sallë zoti Sefa!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Prezent!

Z. E. Çefa: Përpara se të procedojmë, ne jemi të detyruar të shprehemi lidhur me këtë kërkesë. Ju jap fjalën shkurtimisht ju, zoti Sefa!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Për sa kohë është paraqitur një ankim në KQZ, në lidhje me vendimmarrjen dhe përfshin Partinë Demokratike, nga subjekt që nuk është subjekt dhe është e paqartë në emër të kujt është kjo ankesë. Ka përgjegjësi juridike, është organizatë jofitimprurëse, parti politike, apo është individ? Gjithsesi i refrohet Partisë Demokratike. Duke qenë se i referohet Partisë Demokratike, unë si përfaqësues i përhershëm në KQZ i Partisë Demokratike, më lind interesi për të qenë pjesë e këtij shqyrtimi të kësaj ankese që për mua është ende e paqartë se nga kush vjen. Partia Demokratike nuk ka ankimuar vendimin e Komisionerit me nr. 745, faleminderit!

Z. E. Çefa: Qartë, faleminderit! Zoti Sekretar i Përgjithshëm, ju çfarë opinionini keni në lidhje me këtë kërkesë?

Z. Y. Merkaj: Mendoj se kërkesa nuk plotëson elementët e legjitimitetit të ankuesit, pasi nuk është subjekt zgjedhor dhe nuk është përfaqësues i një partie politike....

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.09.2023*

Z. E. Çefa: Po flas për kërkesën që u bë për palë të interesuar?

Z. Y. Merkaç: Mendoj se duhet të pranohet se ka interes të ligjshëm, pasi bëhet fjalë për “çregjistrimin e Partisë Demokratike”.


Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Përfaqësuesi i ankuesit, zoti Nuri!

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Mendoj që të pranohet, përderisa ne kërkojmë çregjistrimin e subjektit të përfaqësuar nga zoti Basha, mendoj se çënohen interesat e tyre, le të pranohen si palë e tretë, në gjykimin tonë!

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit! KAS-i pasi e diskutoi çështjen në vend, vendosi: pranimin e kërkesë së zotit Indrit Sefa për ndërhyrje kryesore në cilësinë e palës së interesuar në këtë gjykim administrativ. Atëherë, kalojmë te kërkesa ankimore për elementët e formës dhe të përmasës, shkurtimisht do t’i jap fjalën Sekretarit të Përgjithshëm dhe më pas ju zoti Nuri!

Z. Y. Merkaç: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 94, me ankimues Partia Demokratike e Shqipërisë, e cila ankimon vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 745, datë 4.09.2023, me anë të këtij ankimi kërkon ndryshimin e këtij vendimi duke vendosur “regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga kryetari zoti Sali Berisha, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24.09.2023”. Nga verifikimi paraprak i kushteve dhe i elementëve formalë të kërkesës, konstatohet se në bazë të nenit 130 plotëson dy kërkesa: kompetencën e KQZ-së dhe kanë respektuar afatin e ankimit. Ndërsa për legjitimitimin, mendojmë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.09.2023*

se nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkesë, pasi nuk është përfaqësues i subjektit zgjedhor. Është përfaqësues i një personi fizik që nuk përfaqëson asgjë në këto zgjedhje, faleminderit!

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit! Zoti Nuri, e keni ju fjalën! Për elementët e formës dhe të përmbajtjes gjithmonë!

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Po, faleminderit zoti relator! Ne kemi depozituar në KQZ kërkesën për t'u regjistruar në zgjedhjet e pjeshme për krytar të Bashkisë Kukës. Në KQZ kemi depozituar dosjen përkatëse dhe Komisioneri në seancën e datës 4 shtator, me vendimin nr. 745, ka vendosur t'i bashkojë të dy çështjet për shqyrtim, si kërkesën e paraqitur nga ana jonë, si atë të paraqitur nga subjekti Partia Demokratike, përfaqësuar nga zoti Basha. Në përfundim ka arritur në konkluzionin të legjitimojë dhe regjistrojë subjektin e përfaqësuar nga zoti Basha, duke mos pranuar dhe duke mos i dhënë të drejtë kërkesës sonë. Pra, duke mosregjistruar Partinë Demokratike të përfaqësuar nga zoti Berisha. Në të njëjtën kohë, ne si palë e interesuar në këtë procedim, na janë cënuar dhe mohuar të drejtat tona nga kjo vendimmarrje e Komisionerit. Kemi gjykuar të arsyeshme të paraqesim ankim në KAS brenda afatit procedural. Ne seancë është e vërtetë që me audio, ndoshta lapsus nga ana e Komisionerit u tha një afat tre ditor, pavarësisht se jemi në dijeni që Rregullatori ka vendosur afat 24 orë për ankimin. Duke qenë se dje ishte festë zyrtare, pra pushim zyrtar, në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative, ne vlerësojmë se jemi brenda afatit procedural në të gjitha rastet për paraqitjen e këtij ankimi. Kërkojmë nga KAS-i pranimin e legjitimitetit dhe kalimin në shqyrtim në themel, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.09.2023*


Z. E. Çefa: Faleminderit zoti Nuri! Një sqarim të vogël! Pavarësisht se në vendimin që ju ankimoni nuk është vendosur pra, në dispozitiv nuk është përfshirë në mënyrë specifike rrëzimi i kërkesës të Partisë Demokratike që ju përfaqësoni, ju e konsideroni veten që legjitimoheni, sepse duke pranuar efektivisht Komisioneri kërkesën e Partisë Demokratike me kryetar zotin Lulëzim Basha, automatikisht ka vendosur rrëzimin “*de facto*” të kërkesës tuaj? Ky është argumenti që ju legjitimoheni në këtë kërkesë?!

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Po është e vërtetë! Jo vetëm “*de facto*”, por dhe “*de jure*”, sepse gjatë vendimmarrjes së tij Komisioneri u muar gjatë dhe me debate se cila palë legjetimohet apo jo dhe se cila palë pati mundësinë të sillte argumentat e vet ligjorë, për të pretenduar, të themi, këtë përkatësi. Kështu që për sa kohë, përmendet dhe në arsyetim që në një mënyrë, apo në një tjetër, nuk është pranuar kërkesa jonë, rrjedhimisht ne na janë cënuar të drejtat, faleminderit!

Z. E. Çefa: Dakord! Nga kolegët, pyetje të tjera?

Z. L. Braho: Kam unë një pyetje për KQZ-në? Nuk e di këtu KQZ-ja i lexon vendimet e Kolegjit Zgjedhor? Jam shumë kurioz! Unë tani po lexoj vendimin e Komisionerit dhe sërish nuk është shprehur për kërkesën, le ta quajmë person fizik, zotit Sali Berisha. Unë të paktën me sa mbaj mend nga vendimi i kolegjit, një nga shqetësimet që kishte ngritur Kolegji ishte pikërisht fakti që Komisioneri nuk ishte shprehur për kërkesën e një subjekti çfarëdo qoftë ai, po që e shqyrton. Shoh që në të njëjtin rast nuk ka fare vendimmarrje. Dakord! Ka pranuar kërkesën e Partisë Demokratike, përfaqësuar nga zoti Lulëzim Basha, po duhet të kishte një “rrëzimin e kërkesës së personit fizik, zotit Sali Berisha”, një gjë të tillë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.09.2023*


Z. Y. Merkaç: E kemi lexuar dhe i lexojmë me shumë vëmendje vendimet e Kolegjit. Ky është vullneti i Komisionerit, kështu e ka gjykuar.

Z. E. Çefa: Zoti Lako, pyetje!

Z. E. Lako: Kam një pyetje për zotin Nuri. Meqenëse kjo çështje pak a shumë është ezauruar edhe në këto zgjedhjet që sapo kaluam. Ka një vendimmarrje të KAS-it të lënë në fuqi nga Kolegji. Ka ndryshuar në këtë periudhë... ka ndonjë vendimmarrje nga ana e gjykatës, ndonjë diçka të re që ne duhet përsëri ta bëjmë... ka ndonjë zhvillim të ri kjo fushë për sa i përket kësaj çështje, për çfarë po investohet përsëri KAS-i?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Zhvillimet e fundit janë rekursi i depozituar në datë 15 maj, në qoftë se nuk jam i gabuar nga zoti Kaso, si përfaqësues ligjor për vendimin e 3 marsit dhe ende nuk ka asnjë vendim ndërkohë, për këtë se çfarë ka ndodhur nga Gjykata e Lartë për çështjen e themelit të konfliktit. Pastaj ka zhvillime brenda Partisë Demokratike, sikurse të gjithë e dimë. Një palë që pretendon se ka kryer zgjedhje, pala tjetër i ka kundërshtuar këto dhe nga Gjykata e Tiranës, ne kemi depozituar një praktikë, një shkresë përcjellëse, përgjigje zyrtare nga nënkryetari i gjykatës në mos gaboj të datës 30 gusht, ku figuron i regjistruar në regjistrin e partive politike, regjistrimi i fundit është vetëm vendimi Apelit. Pra, nuk ka rizgjedhjen e zotit Basha. Pak a shumë ky është thelbi që ne kapemi dhe vijmë pastaj për regjistrimin ndër të tjera, sepse zoti Basha... nuk është aktuale le të themi regjistri i partive politike, sikundër nuk ishte aktuale dhe në muajin mars kur ju e shqyrtuat dhe u procedua me nënkryetarin zotin Alibej. Ndryshimi tjetër është që zoti Alibej paska dhënë dorëheqjen dhe forumet përkatëse që e kanë njohur si nënkryetar e kanë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.09.2023*

pranuar dorëheqjen, pra nuk ka më as nënkryetar, po themi ai segment, në qoftë se mund të shprehemi kështu. Edhe padija e zotit Bardhi, e kemi depozituar shkresën në praktikë. Në dijeninë time, aq sa e kam parë pa u thelluar është një padi që kundërshton zgjedhjet, ose procesin e thirrjes së Kuvendit Kombëtar dhe zgjedhjet që pretendohet se janë kryer për kryetarin zotin Basha. Pra, ka një ngërç...

Z. E. Çefa: Atëherë, pyetje të tjera? Nuk ka! Zoti Sefa, keni fjalën!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Me sa shoh Komisioneri nuk e ka legjitimuar fare këtë subjektin imagjinar, sepse nuk ka dalë asnjë vendim dhe në arsyetim ka thënë që “në pretendimet e zotit Nuri, nuk gjetëm mbështetjen në ligj... si i tillë zoti Basha ka legjitimitetin e plotë për të bërë kërkesën në emër të PDSH për regjistrimin si subjekt zgjedhor...etj.”, e para! E dyta; kërkesa nuk plotëson elementët e ligjit, duke filluar nga kodi i Procedurës Civile e të gjitha me rradhë. Për faktin e vetëm, po marr rast një shembull, një shoqëri tregtare identifikohet me numër nipti, me emër dhe me emër administratori, i cili është dhe përgjegjësi për të nënshkruar aktet e kësaj shoqërie tregtare. Kështu funksionon dhe për shoqatat jofitimprurëse, por dhe për partitë politike. Në rast se zoti Berisha si individ, do të ankohej bënte sens, por Partia Demokratike nuk është ankuar. Unë jam personi i vetëm që përfaqësoj Partinë Demokratike në këtë komision. Si e tillë dhe nga ana formale, kjo ankesë nuk duhej shqyrtuar përveç faktit që nuk mund të legjitimohet nga ky organ edhe si pasojë e vendimmarrjeve të ngjashme të mëparshme të cilat janë gjykuar në KAS dhe janë lënë në fuqi nga Kolegji Zgjedhor. Është praktikë e ezauruar gjerësisht tani më nga ky organ dhe mendoj që dhe praktika vijuese do të jetë në frymën e të njëjtës praktikë të mëparshme. Për sa i përket pretendimeve të zotit Nuri, ligji “Për Partitë Politike”

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.09.2023*

është fare i qartë, i jep rëndësi të jashtëzakonshme vetorganizimit të brendshëm dhe si i tillë nuk...

Z. E. Çefa: Po zoti Rusmali!

Z. I. Rusmali: Për zotin Sefa kam një pyetje unë! Ju thoni që në vendimin e tij nr. 745, Komisioneri nuk e ka legjitimuar subjektin tjetër...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Është interpretimi im...

Z. I. Rusmali:... në procedurë. Mua më rezulton nga vendimi që “nuk është shprehur për moslegjitimimin” Komisioneri, sikurse nuk është shprehur specifikisht për bashkimin e dy kërkesave në një të vetme, siç është shprehur përpara disa muajsh. Në arsyetim i ka qëndruar arsyetimit për të dy palët, për kërkesën e parë dhe të dytë, pra, ka analizuar të dy kërkesat, pavarësisht se në mënyrë eksplicite nuk është shprehur, as për moslegjitimimin, por as për bashkimin në një të vetme. Kjo është e vërtetë, ky lexim është i saktë, apo jo?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: I bashkoi çështjet, ishte objekt debati.

Z. I. Rusmali: Ka vendim të ndërmjetëm për bashkimin?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Po! Se nuk është zbardhur...

Z. I. Rusmali: Kjo nuk ka rëndësi! Kemi procesverbalin! Pra, ka vendim të ndërmjetëm për bashkimin në një të vetme? E konfirmon KQZ-ja këtë gjë? Faktin

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.09.2023*

që Komisioneri ka diskutuar çështjen e bashkimit të të dy kërkesave dhe ka rënë dakord që t'i shqyrtojë në një të vetme?

Z. Y. Merkaj: Jo nuk është evidentuar. Ka qenë vetëm një kërkesë që është paraqitur nga administrata dhe një kërkesë e vetme që...

Z. I. Rusmali: Po ai i ka analizuar të dyja kërkesat?

Z. Y. Merkaj: Po, ishin dy kërkesa që u bashkuan në një!

Z. I. Rusmali: Pra, janë bashkuar në një? Se në arsyetim e keni...

Z. Y. Merkaj: Në relatimin tonë ishte kështu, dy persona të ndryshëm kanë bërë kërkesë për të regjistruar Partinë Demokratike si subjekt zgjedhor.


Z. I. Rusmali: Të lutem zoti Sekretar i Përgjithshëm, nuk është pyetja.., se kjo është e qartë nga vendimi, nuk është pyetja i ka shqyrtuar të dyja, apo jo? Pyetja është, a ka nja akt formal, vendim të ndërmjetëm që të thotë “vendosa bashkimin e të dy çështjeve në një të vetme”?

Z. Y. Merkaj: Nuk ka!

Z. I. Rusmali: Nuk ka! Por “*de facto*” i ka shqyrtuar të dyja.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Zoti Ylli, në vlerësimin tim, akti formal ndodhi, sepse Komisioneri e diskutoi si çështje dhe pati kundërshtimin e menjëhershëm të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.09.2023*

zotit Sefa, i cili e shprehu në seancë, në mos gaboj, do të mundohem ta citoj, tha “kjo punë do të sjellë vonesa në regjistrim, në ankimim, etj., etj., nga pala jonë”. Komisioneri mori dhe mendimin tonë si palë e interesuar. Unë u shpreha për bashkimin e çështjeve, sepse çështja është e njejtë, bëhet fjalë për një Parti Demokratike etj., etj., dhe Komisioneri vendosi t’i shqyrtojë bashkarisht. Mjafton të hapni audion, ose procesverbalin. Kjo është e qartë se dhe “*de facto*” për pjesën e legjitimit, në fillim në faqen nr. 2 të vendimit, pavarësisht se vendimi është i shkurtër dhe ndoshta nuk janë nxjerrë të gjithë elementët që janë diskutuar, madje shoh që dhe ajo pjesë ku unë citohem.., jam cituar gabimisht totalisht, sepse nuk i jam referuar fare kësaj shkrese që referohet këtu, kjo është tjetër çështje. Në faqen nr. 2, këtu përmendet që “kërkuesi, zoti Berisha në shoqërim të kërkesës së tij për regjistrimin e Partisë Demokratike ka paraqitur këto dokumenta:..”. Pra, përmendet që pas kërkuesit zoti Basha, ka ardhur dhe kërkuesi zoti Berisha me këto dokumenta që ka, me ato që ka.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Meqenëse e ezauruam këtë fazë, KAS do të tërhiqet pesë minuta për ta diskutuar çështjen dhe do t’ju lajmërojmë.

Rifillon seanca

Ora, 15:08

Z. E. Çefa: E riçelim seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 94. KAS pasi e konsultoi çështjen në tërësi në dhomë këshillimi, vendosi:

- Kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore me nr. 94.
- Seanca për shqyrtimin e themelit të kësaj çështje do të caktohet ditën e nesërme në orën 12:00 në këtë sallë.

Me kaq këtë seancë e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 180

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

